



Prishtinë, 08.10.2019

**Përgjigjet në komentet e pranuar gjatë procesit të konsultimit publik  
për  
Shqyrtimin e tarifave të energjisë termike – Raporti për të Hyrat e Lejuara për NQ  
Termokos – sezoni 2019/2020**

## 1. Hyrje

Në përputhje me kërkesat ligjore, me datë 20 shtator 2019, ZRRE ka nxjerrë në konsultim publik Draft Raportin: Vlerësimet Preliminare për Përcaktimin e të Hyrave të Lejuara për NQ Termokos për sezonin 2018/2019. Me këtë rast të gjithë palët e involvuara dhe publiku i gjerë janë ftuar për të dhënë komentet e tyre në këtë Raport. Po ashtu në kuadër të procesit të konsultimit publik, ZRRE ka patur takim me NQ Termokos ku janë diskutuar dhe dhënë shpjegime për disa nga komponentët kryesorë të të Hyrave të lejuara. Gjatë konsultimit publik ZRRE ka pranuar komentet me shkrim nga NQ Termokos, KEK Sh.A. dhe Banka Gjermane për Zhvillim (KfW); në vijim janë dhënë përgjigjet në këto komente.

## 2. Përgjigjet në komentet e pranuar nga NQ Termokos

### **Koment 1: Kostoja e energjisë termike nga kogjenerimi në TC Kosova B**

*“Për të përfshirë energjinë elektrike të shpenzuar në HES, bazuar në dakordimin në mes KEK -Termokos dhe ZRRE ( sipas minutave të takimit dhe raportit të dërguar nga KEK), çmimet e reja për kapacitet dhe energji termike janë;*

*Për kapacitet 21.28 €/MWh/h dhe*

*Për energji termike 1.39 €/MWh.*

*Nga kjo rezulton se kostoja për kapacitet është 38,300.00 MWh/h x 21.28€ = 815,024.00 €/MWh/h.*

*Ndërsa, kostoja për energji termike është 251,148.00 MWh x 1.39€ = 349,234.72 €/MWh.”*

### **Përgjigje**

Komenti i NQ Termokos për koston e energjisë termike nga kogjenerimi ka të bëjë me përfshirjen e koston së ndërlidhur me konsumin e energjisë elektrike në Stacionin e Ekstraktimit të Energjisë Termike (HES) në TC Kosova B.

Në stacionin e ekstraktimit të energjisë termike i cili ndodhet në lokacionin e termocentralit Kosova B, në shkurt 2017 është instaluar matësi i energjisë elektrike për matjen e konsumit të energjisë elektrike në HES. Perkunder leximeve të rregullta të konsumit, deri me tani nuk është faturuar NQ Termokosit nga KEK për konsumin e energjisë elektrike në HES.



Në takimin e përbashkët ZRRE-KEK-NQ Termokos, mbajtur me 30.09.2019, për këtë qështje janë shqyrtuar modalitetet dhe metodologjia e propozuar për llogaritjen e këtij konsumi dhe perfshirjen e kesaj kostoje në koston e përgjithshme të energjisë termike nga kogjenerimi. Të gjitha palët në takim janë pajtuar që metodologjia e përdorur të merr për bazë gjithë konsumin për tërë periudhën nga instalimi i matesit (shkurt 2017 – shtator 2019) dhe konsumin e parashikuar për periudhën vijuese të sezonit të ngrohjes 2019/2020, si dhe që kjo kosto e konsumit të energjisë elektrike në HES të reflektohet si një mesatare mujore e perfshirë në cmimin njësi të energjisë termike nga kogjenerimi. Kjo qështje më gjerësisht është elaboruar në Minutat e takimit bashkangjitur me Metodologjinë përkatëse.

Bazuar në sa u shpjegua më lartë çmimi njësi i energjisë termike ka ndryshuar si në vijim:

- Çmimi për kapacitetin e rezervuar elektrik: 21.28 €/MWh<sub>EL</sub>/h; dhe
- Çmimi për sasinë e energjisë termike: 1.39 €/MWh<sub>TH</sub>

Në vlerësimin për këtë kosto, ZRRE është bazuar në sasinë e planifikuar të kapacitetit elektrik dhe sasisë së ekstraktuar të energjisë termike (që kanë qenë në përputhje me bilancet e energjisë) dhe çmimeve njësi përkatëse, ashtu siç janë propozuar nga NQ Termokos; teksti i cituar në vijim:

- *“Komponenti i pagesës për kapacitet të rezervuar e propozuar nga NQ Termokos ka është bazuar në kapacitetin e rezervuar elektrik: 38,300 MWh<sub>EL</sub>/h dhe ngarkesën respektive: 20.30 €/MWh<sub>EL</sub>/h;*
- *Vlerësimi – Propozimi i NQ Termokos për kapacitetin e rezervuar vlerësohet është kryesisht real dhe i bazuar në Bilancet e energjisë; nga llogaritjet rezulton se komponenti i **pagesës për kapacitetin e rezervuar është 777,490€;***

*Komponenti variabil i pagesës për sasinë e energjisë termike është bazuar në sasinë e planifikuar prej 251,248 MWh<sub>TH</sub> dhe çmimin (ngarkesën) prej 1.33 €/MWh<sub>TH</sub>.*

- *Vlerësimi – Propozimi i NQ Termokos vlerësohet se është kryesisht real dhe i bazuar. Duhet theksuar gjithashtu se është përfshirë edhe komponenta e pagesës për taksën vjetore të licencimit, e cila llogaritet bazuar në taksën vjetore të licencave për prodhimin e energjisë termike të përcaktuar sipas Rregullës për Taksat të nxjerrë nga ZRRE. Llogaritjet rezultojnë si në vijim:*
  - *Komponentii pagesës për sasinë e energjisë termike: 334,160 €; dhe*
  - *Komponentii pagesës për taksën vjetore të licencimit: 25,125 €.”*

Duke marrë parasysh shpjegimet dhe detalizimet më lartë ZRRE pranon komentin e NQ Termokos dhe rillogaritë koston e energjisë termike nga kogjenerimi si në vijim:

- Komponenta fikse e pagesës për kapacitet të rezervuar elektrik:  
 $38,300 \text{ MWh}_{EL}/h * 21.28 \text{ €/MWh}_{EL}/h = 815,024 \text{ €}$
- Komponenta Variabile:  
Pagesa për sasinë e energjisë termike:  $251,248 \text{ MWh}_{TH} * 1.39 \text{ €/MWh}_{TH} = 349,235 \text{ €}$   
Pagesa për taksën vjetore të licencimit:  $251,248 \text{ MWh}_{TH} * 0.10 \text{ €/MWh}_{TH} = 25,125 \text{ €}$   
**Total komponenta variabile: 374.360 €**



## **Koment 2: Kostot e shitjes dhe tjera administrative**

*“Sa i përket nën-komponentës “Shpenzimet e provizioneve të llogarive të arkëtueshme”, ky zë nuk paraqet qështjen e cekur nga ZRRE për arse se kjo nuk ka të bëjë me Ligjin për Faljen e Borxheve Publike (marrë parasysh se Ligji nuk është në fuqi nga vitit i kaluar), por ka të bëjë me shumat të cilat Ndërmarrja nuk mund t’i inkasojë gjatë vitit afarist, të cilat pastaj i njohim si shpenzime dhe në momentin e inkasimit i njohim si të hyra (Shih shpalosjen e Pasqyrës B, Konto 41125 - Të hyrat nga inkasimet e borxheve të këqia). Andaj, si pasojë e faktit që ndërmarrja pothuajse asnjehere nuk ka mundur të inkasoj 100% të shumës së faturuar, gjithnjë ka mbetur një diferencë mes Shpenzimeve dhe të Hyrave (në favor të Shpenzimeve) e cila ndikon në Fitimin/Humbjen e Ndërmarrjes.*

*Kurse, sa i përket Kontributeve Pensionale dhe Taksa e Licensimit, jemi dakord për këto ndryshime.”*

### **Përgjigje:**

Fillimisht duhet theksuar se, nga detajimet e ofruara, vërehet që në kostot e shitjes dhe tjera administrative e cila është propozuar nga NQ Termokos në vlerë tejet të madhe 938,809 €, janë të përfshira:

- Nën-komponenta “shpenzimet e provizioneve të llogarive të arkëtueshme” në vlerë prej 641,132 €;
- Nën-komponenti “kontributet për sigurim pensional” ku është paraqitur një vlerë mjaft e madhe prej 89,554 €; dhe
- Nën-komponenti: “shpenzimet për licencë të shpërndarjes së ngrohjes” në vlerë 25,718 €.

Në vlerësimin e kësaj kostoje të paraqitur në Raport është sqaruar se nën-kuptohet se këto dy nën-komponentë janë të ndërlidhur me procesin e shlyerjes së borxheve gjer në vitin 2008 në përputhje me Ligjin për faljen e Borxheve Publike respektivisht pamundësisë së arkëtimit të tyre. ZRRE e vlerëson këtë si një operacion kontabël i domosdoshëm për të reflektuar shlyerjen e borxheve sipas ligjit në fjalë dhe rrjedhimisht këtë kosto nuk e konsideron si subjekt të shqyrtimit tarifar. Në fakt kjo nën-komponentë trajtohet dhe është e përfshirë në pozicionin e tjera të të Hyrave të lejuara si Borxhi i Keq. Më konkretisht në vijim:

- Në pajtim me dispozitat e Rregullës për Vendosjen e Çmimeve të Energjisë Termike, kostoja e borxhit të keq llogaritet si përqindje e arsyeshme në të hyrat e ndërmarrjes (d.m.th. vlerën e faturimit nga shitja e ngrohjes). Kjo ‘përqindje e arsyeshme’ duhet të caktohet në atë mënyrë që të nxis ndërmarrjen për të shtuar përpjekjet për rritjen e nivelit të arkëtimit të pagesave nga konsumatorët, por njëkohësisht merr parasysh se një shumë e konsiderueshme objektivisht nuk mund të arkëtohet, pra do të mbetet si borxh që faktikisht nuk do të realizohet. Nga sa u tha më lartë ZRRE mendon se niveli i borxhit të keq prej 5% është i arsyeshëm, dhe rrjedhimisht kostoja e borxhit të keq llogaritet në vlerën prej **314,440 €**, i cila është kategorizuar nën kostot variabile. Gjithashtu edhe praktikat e rregullimit të çmimeve si në vend ashtu edhe ndërkombëtare e përcaktojnë përqindjen e arsyeshme të borxheve të këqija në një nivel prej 5%.
- Ndërsa për komponentën “kontributet për sigurim pensional” ZRRE konsideron se kjo vlerë i përket dhe alokohet tek ‘kostoja e personelit’.
- Gjithashtu komponenta e taksës së licensimit nuk reflekton vlerën e prodhimit të energjisë në stabilimentet e ngrohjes, dhe e cila është alokuar nën ‘kostat tjera variabile’.

Nga argumentimet më lartë ZRRE mbetet pranë vlerësimeve të veta për mos-përfshirje të këtyre tre nën-komponentëve të lartpërmendur në Kostot e Shitjes dhe Tjera Administrative, dhe rrjedhimisht këto kosto lejohen në vlerën **182,415 €**, siç është përcaktuar në Raport.



### **Koment 3: Investimet e reja me vetë-financim – Ndërtimi i objektit të NQ Termokos**

Lidhur me investimet e reja me vet-financim, konkretisht për ndërtimin e objektit të zyrës qendrore dhe administrative të NQ Termokos ka dërguar një shpjegim shtesë si në vijim:

- Lidhur me caktimin e lokacionit për ndërtimin e ndërtesës të zyrës qendrore administrative të NQ Termokos, me datë 20 shtator '19, Termokosi ka dërguar në ZRRE "Vendimin për përcaktimin e parcelave katastrale" të lëshuar nga Komuna e Prishtinës.
- Gjithashtu sa i përket çështjes së zhvillimit të projektit në fjalë, procesi është në fazën tenderuese për përzgjedhjen e kompanisë për Projektin ideorë.

#### **Përgjigje:**

ZRRE në Raportin për konsultim publik ka dhënë informata detaje për këtë projekt investiv, ku ndër tjera janë përkrahur edhe shpjegimet në komentin e NQ Termokos. Citimi përkatës nga Raporti i ZRRE-së në vijim:

*"Në Investimet e reja me vetëfinancim, ndër tjera, është planifikuar edhe ndërtimi i ndërtesës të zyrës qendrore administrative të NQ Termokos në vlerë prej 530,000 €. Lidhur me këtë investim duhet theksuar se realizimi i këtij projekti është ngusht i ndërlidhur me përcaktimin e lokacionit dhe procedurave administrativo-ligjore për marrjen e pëlqimit/kushteve ndërtimore-urbanistike si hapa paraprirës në zhvillimin e projektit detal dhe marrjen lejes ndërtimore. Sipas konfirmimit nga NQ Termokos janë ndërmarrë masa për përcaktimin e lokacionit në bashkëpunim të ngushtë me Komunën e Prishtinës ku është lëshuar vendimi për bashkimin e parcelave për lokacionin e ndërtimit. Gjithashtu është përfundim e sipër Projekti ideorë ma paramasat e ndërtimit, planin e zhvillimit të projektit (pritet të kryhet në fund të tetorit 2019, i cili do të shërbej mëtutjje për hartimin e projektit detal ndërtimor dhe për procedurat e tenderimit për përzgjedhje të kryesit të punimeve; sipas planit dinamik punimet parashihen të fillojnë në mars 2020. Duke marrë parasysh sa u tha më lartë ZRRE, për këtë periudhë njëvjeçare të shqyrtimit tarifor, pranon vlerën e propozuar prej 530,000 €."*

Siç mund të vërehet në citimin më lartë në Raportin e ZRRE-së kanë qenë të përmendura masat e ndërmarrë për përcaktimin e lokacionit të ndërtimit dhe Vendimi i Komunës, si dhe për përgatitjen e Projektit ideorë. Këto masa të konfirmuara nga NQ Termokos kanë shërbyer si bazë për lejimin e këtij Investimi në vlerën e planifikuar prej 530,000 €.

### **3. Përgjigjet në komentet e pranuar nga KEK sh.a.**

#### **Koment 1: Kostoja e energjisë termike nga kogjenerimi**

Komentet e KEK sh.a. kanë trajtuar qështjen e kostos së energjisë termike nga kogjenerimi. Konkretisht qështjen e përfshirjes së konsumit të energjisë elektrike në Stacionin e ekstraktimit të energjisë termike (HES) në koston e përgjithshme të energjisë termike nga kogjenerimi. Është qështja e njëjtë e cila shpjegohet më lartë në përgjigjet në komentet e NQ Termokos (pika '2' komenti '1').

#### **Përgjigje**

Qëndron e njëjta përgjigje si për NQ Termokos – Përgjigja e ZRRE-së në komentin '1', pika '2'.



#### **4. Përgjigjet në komentet nga Banka Gjermane për Zhvillim (KfW)**

Nga KfW janë pranuar dy komente që kanë të bëjnë me koston e mazutit për prodhim të energjisë termike (ngrohjes) në impiantet e ngrotores së Termokosit dhe me koston e personelit që të ndërlidhet me performacën e kompanisë. Me detajisht komentet në vijim:

##### **Koment 1: Kostoja e mazutit për prodhimin e energjisë termike**

*“Termokos ka pasur të lejuara të hyra për mazut në sezonat e kaluara, si rezerve në rast të rënies së kogjenerimit. Lejimi të hyrave prej 319, 500 EUR për mazut nenkupton që Termokos nderkohe ka hargjuar rezervat e kaluara të mazutit?”*

##### **Përgjigje:**

Sa i përket prodhimit të energjisë termike në ngrohtoren e Termokosit, fillimisht duhet theksuar se, me funksionalizimin e projektit të kogjenerimit stabilimentet (kaldajat) e prodhimit të energjisë termike janë kapacitet rezervë për tu aktivizuar vetëm në rastet e ndërprerjeve të paplanifikuara (avarive) të stabilimenteve të TC Kosova B. Kështu që përdorimi i tyre eventual do të zgjaste për periudha të shkurtëra gjersa të kryhen riparimet e nevojshme. Në këtë kuptim ZRRE për çdo sezon të ngrohjes lejon si planifikim një sasi të arsyeshme të mazutit që duhet të ketë të jetë në dispozicion për tu përdorur për prodhim të energjisë termike në rast të ndërprerjes së prodhimit nga kogjenerimi.

Së pari duhet shpjeguar se ZRRE e përdorë mekanizmin e axhustimit (përshtatjes) të planifikimeve me realizimet që shërben për të korrigjuar ndryshimet eventuale mes planifikimeve të shqyrtimit tarifar për periudhën (sezonin) ‘n-1’ dhe realizimeve që faktikisht kanë ndodhur në atë periudhë (sezon) dhe ato ndryshime përfshihen (korrigjohen) në shqyrtimin e ardhshëm. Pë rastin konkret të koston së mazutit, në rastet kur na ka pasur prodhim të energjisë termike nga mazuti, pra nuk është shkaktuar kostoja e mazutit atëher atë kosto e zbrit (minuson) përmes mekanizmit të axhustimit /përshtatjes (shiko kapitullin 3.6 të Raportit të ZRRE-së). Pra axhustimi, ndër komponentet tjera përfshinë edhe kostot operative ku bën pjesë edhe axhustimi për koston e përealizuar të mazutit.

##### **Koment 2: Kostoja e personelit**

*“Kostot e personelit: përveq vërejtjeve të rregullatorit në lidhje me ngritjen e të hyrave për personel do të ishte e rekomandueshme për shqyrtimet e ardhshme të aplikohet ndonjë formulë me indikatorë të performancës së kompanisë. Konkretisht, ngritja e kostos së personelit të vlerësohet në relacion me indikatorët e performancës së kompanisë.”*

##### **Përgjigje:**

ZRRE pajtohet me konstatimin se duhet përdorur indikatorët e performancës për të vlerësuar këtë kosto. ZRRE po ashtu konfirmon se përcaktimit të indikatorëve të performancës duhet t’i paraprij një studim gjithpërfshirës për ‘koston e shërbimit’, ku në radhë të parë inputi kryesor do të merrej nga ndërmarrja si ofrues i shërbimit të ngrohjes por edhe do të bëhej një krahasim (‘benchmarking’) me sektorët e ngrohjes në vendet e regjionit për shembull. Ne do mirëprisnim çdo diskutim dhe iniciativë të përbashkët me KfW për modalitetet e dhe mundësitë për hartimin e një studimi të tillë.